



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 04, datë 17.02.2016

PËR

RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR LINJËN AJRORE TË INTERKONJEKSIONIT 400 KV SHQIPËRI-KOSOVË, MIRATUAR NË KKT ME VENDIM NR. 2, DATË 03.12.2014, ME SUBJEKT KËRKUES SHOQËRINË “OST” SH.A.

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, dhe Vendimit Nr. 2, datë 03.12.2014 “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për linjën ajrore të interkonjeksionit 400 kv Shqipëri-Kosovë”, me subjekt zhvillues “OST” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të Lejes së Ndërtimit për linjën ajrore të interkonjeksionit 400 kv Shqipëri-Kosovë, miratuar në KKT me Vendimin Nr. 2, datë 03.12.2014, me subjekt zhvillues shoqërinë “OST” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues vetëm pas:
 - a) miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë e shpronësuara;
 - b) rishikimin e kushteve të Lejes Mjedisore, sipas gjurmës së re të miratuar;
 - c) pagesës së taksave së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të bashkive, sipas juridiksionit përkatës territorialo - administrativ.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDITH RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENTI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

